



BULETINI

Botimi Nr.

05

MUJOR QERSHOR 2026



01 QERSHOR

Dita e Fëmijëve:

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit priti fëmijë në ambientet e saj, duke theksuar përkushtimin e institucionit për të ndërtuar një të ardhme me më shumë mundësi, siguri dhe mirëqenie për ta.



02 QESHOR

Marrëveshja për Sigurimet Shoqërore me Poloninë:

U prezantua në Kuvend projektligji për ratifikimin e marrëveshjes Shqipëri-Poloni për Sigurimet Shoqërore, i cili garanton bashkimin e periudhave të sigurimit dhe mbrojtjen e qytetarëve në të dy vendet. Projektligji u shqyrtua nga gjashtë komisione të ndryshme parlamentare.



03 QESHOR

Digjitalizimi i Shërbimeve Publike:

Në një workshop të përbashkët me sektorin bankar dhe AKSHI-n, u diskutuan hapat për zgjerimin e pagesave elektronike dhe reduktimin e burokracive për ta bërë ndërveprimin me shtetin plotësisht digjital.

PROGRAMI *i* Vetëpunësimit



03 QERSHOR

Takim në Shkollën Teknike: Ekonomike:

U zhvillua një diskutim me maturantët mbi Programin e Vetëpunësimit, ku ata u ftuan të aplikojnë deri më 4 Qershor 2026 për mbështetje financiare në hapjen e bizneseve të tyre.



03 QERSHOR

Raportim në Kuvend për Negociatat me BE:

U prezantua në Komisionin për Evropën dhe Punët e Jashtme ecuria e negociatave për Kapitujt 2 (Lëvizja e lirë e punëtorëve), 3 (E drejta e vendosjes dhe ofrimi i shërbimeve) dhe 19 (Politikat sociale dhe të punësimit).



04 QERSHOR

Komiteti Konsultativ Shqipëri-BE:

Tirana mikpriti Takimin e III-të të Komitetit të Përbashkët Konsultativ, një platformë thelbësore dialogu mes institucioneve, biznesit dhe shoqërisë civile për procesin e integritit evropian.



05 QERSHOR

Bashkëbisedim në Shkollën “Sami Frashëri”:

Një diskutim inkurajues me të rinjtë u fokusua tek inovacioni, teknologjia dhe mundësitë që ofrojnë programet e qeverisë për të rinjtë me ide sipërmarrëse.



05 QERSHOR

Inaugurimi i Selisë së re të Lutech:

Inaugurimi i selisë së re të kompanisë Lutech në Tiranë, ku mbi 250 profesionistë shqiptarë janë pjesë e Qendrës Globale të Kompetencës. Ky investim, i cili përfshin edhe praninë e tyre në Durana Tech Park, sjell më shumë mundësi për punësim të kualifikuar dhe transferim njohurish në teknologji dhe inteligjencë artificiale.



05 QERSHOR

Takim Dypalësh me Egjiptin:

U zhvillua një takim me Ministrin e Punës të Egjiptit, z. Hassan Raddad, për të thelluar bashkëpunimin në mobilitetin e fuqisë punëtore dhe politikat e tregut të punës.



05 QERSHOR

Konferenca Ndërkombëtare e Punës në Gjenevë:

Gjatë Sesionit të 114-të të OKB-së, u prezantua progresi i Shqipërisë në dialogun social dhe u diskutuan politikat e punësimit në përgjigje të sfidave nga Inteligjenca Artificiale.

SHQIPËRIA 2030

1 në 3 nxënës të regjistruar
në Arsim Profesional

09 QERSHOR

Konferenca Kombëtare e Arsimit Profesional 2026:

U theksua rëndësia e arsimit dhe formimit profesional, sektor ku sot studiojnë mbi 17 mijë të rinj dhe ku punësueshmëria e të diplomuarve ka arritur në 63%.



10 QERSHOR

Komiteti i Monitorimit të IPA III:

U prezantua progresi i Programit Shumëvjeçar për Punësimin e të Rinjve 2024–2027 dhe theksoi miratimi i Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore 2026–2028.



10 QERSHOR

Fushata e Takimeve “Aftercare”:

AIDA nisi fushatën e takimeve me investitorët e huaj përmes një takimi me kompaninë italiane Maccaferri, për të diskutuar mbi nevojat e tyre dhe menaxhimin e rreziqeve financiare si kursi i këmbimit.



15 QERSHOR

Shqyrtimi i Investimeve të Huaja:

Në organizimin e Dhomës Amerikane të Tregtisë u prezantua Mekanizmi Shqiptar për Shqyrtimin e Investimeve të Huaja Direkte, në një kohë kur IHD-të për vitin e kaluar shënuan mbi 1.6 miliardë euro.



16 QERSHOR

Aktiviteti "Green & Digital Innovation":

U theksua roli i startup-eve në transformimin e ekonomisë, duke përmendur histori suksesi vendase si QELQ, EKOFUNGI, Alter Ego, Brisk Square dhe Match4Research.



16 QERSHOR

Profesionet e Rregulluara:

U zhvillua takimi konsultues për Planin Kombëtar të Veprimit që synon rritjen e transparencës për profesionet e rregulluara, si pjesë e përafrimit me standardet e BE-së (Kapitulli 3).



18 QERSHOR

Konsultim për Pagesat e Vonuara:

U mbajt konsultimi publik për projektligjin që kufizon afatet e pagesave në kontrata tregtare deri në 60 ditë dhe parashikon zbatimin automatik të kamatëvonesave.



19 QERSHOR

Komisioni i Përbashkët Shqipëri-Poloni:

Në Varshavë u përmbyll Sioni i VIII i Komisionit për Bashkëpunim Ekonomik dhe Forumi i Biznesit Shqipëri-Poloni, ku u nënshkrua dhe Protokoli i Sesionit për thellimin e tregtisë dhe investimeve.



19 QERSHOR

Akreditimi i Institucioneve të Arsimit Profesional:

U shpërndanë certifikatat e akreditimit për 9 institucione të AFP-së, një proces i realizuar në partneritet me qeverinë zvicerane dhe UNDP për garantimin e standardeve evropiane.



19 QERSHOR

Konsultim mbi Strategjitë Ekonomike:

Nën drejtimin e Zv. Ministrit Martin Kajo u diskutuan dy dokumente kyçe me grupet e interesit: Strategjia Kombëtare e Industrisë 2026–2030 dhe Dokumenti i Politikave për NVM-të 2026–2030.



23 QERSHOR

Memorandum me Eni S.p.A.:

U nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit me kompaninë Eni S.p.A. për nisjen e një studimi fizibiliteti lidhur me krijimin e kapaciteteve kombëtare të magazinimit të naftës dhe gazit.



23 QERSHOR

Përgjegjësia Sociale dhe Gjelbërimi:

Në një takim me sektorin privat u diskutua përfshirja e bizneseve në aksionin kombëtar të mbjelljes së pemëve për të pasuruar fondin pyjor.



24 QERSHOR

Konsultimi i Dytë për Profesionet e Rregulluara:

Me mbështetjen e GLZ, u mbajt takimi i dytë konsultues me sektorët e shëndetësisë, veterinarisë, arsimit dhe turizmit, me fokus standardizimin e procedurave dhe njohjen automatike të kualifikimeve.



25 QERSHOR

Nënkomiteti Shqipëri-BE:

Në mbledhjen e 17-të të Nënkomitetit për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën u raportua progresi i Shqipërisë në fusha si mbrojtja e konsumatorit, prokurimi publik dhe të drejtat e pronësisë intelektuale.



25 QERSHOR

Nënkomiteti Shqipëri-BE:

Në mbledhjen e 17-të të Nënkomitetit për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën u raportua progresi i Shqipërisë në fusha si mbrojtja e konsumatorit, prokurimi publik dhe të drejtat e pronësisë intelektuale.



26 QERSHOR

JunctionXTirana:

U përcoll një mesazh falënderimi nga organizatorët e eventit për Ministrinë dhe mbështetjen e vazhdueshme ndaj ekosistemit të inovacionit në Shqipëri.



29 QERSHOR

Treguesit Ekonomikë T1 2026:

Në një konferencë për mediat u theksua rritja e ekonomisë shqiptare me 3.71% për tremujorin e parë të vitit, mbështetur nga rritja e konsumit, investimeve dhe eksporteve.



Hellenic Business Association of Albania
Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri

AI BUSINESS SUMMIT

Mr. M.

Deputy Minister

AI BUSINESS
SUMMIT II
AI in Practice

Powered by Accenture

vation

29 QERSHOR

AI Business Summit II:

U zhvillua me sukses forumi mbi Inteligjencën Artificiale, i organizuar nga Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri (HBAA) dhe Accenture Greece, duke afruar më shumë bashkëpunimin mes akademisë dhe biznesit.